

VITI XV, NUMRI 1 / JANAR 2011

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

Happy New Year!
IK
2011



Ja ku jemi përsëri në pragun e një viti të ri. Jemi në pragun e 2011 dhe libri i këtij viti nuk është gjë tjetër veçse një radhë faqesh bosh. Lindja e një viti të ri zgjon tek ne dëshirën për jetën, ndjenjën e shpresës drejt një të ardhmeje të panjohur. Kemi plot kujtime të mira të vitit që shkoi, por tani jemi në pritje për çfarë na sjell e nesërmyja. Dhe kjo është gjëja që më pëlqen më shumë kur fillon një vit i ri. Unë jam plotësisht i lirë që të bëj atë që dua. Pavarësisht se çfarë ndodhi vitin e kaluar, apo edhe një vit më parë, apo edhe në dhjetë vitet e fundit, unë kam mundësinë që këtë vit të bëj çfarë kam vendosur në mendjen dhe në zemrën time. Mendoj që i vetmi faktor që na shtyn të gjithëve përpara, pavarësisht nga rrethanat, është shpresa. Shumë njerëz të mëdhenj kanë folur për shpresën.

Le të citoj vetëm disa prej tyre:

“Çdo gjë që është bërë në këtë botë është bërë nga shpresa.”
Martin Luther King

“Nuk duhet ta lëmë frikën që të na pengojë në ndjekjen e shpresave tona.”
John F. Kennedy

“Optimizmi është besim që të çon në arritje. Asgjë nuk mund të bëhet pa shpresë dhe pa besim.”
Hellen Keller

“Shpresa vepron në këto mënyra: ajo kërkon më të mirën tek njerëzit, në vend që ti bëjë jehonë të keqes; ajo zbulon çfarë mund të bëhet, në vend që të grindet për çfarë nuk mund të bëhet; ajo i shikon problemet, të mëdha apo të vogla, si mundësi; ajo të shtyn përpara, kur do të ishte më e lehtë të braktisje; në vend të mallkimit të errësirës, ajo ndez qiririn për të parë”
Anonim

Shpresa

Më lejoni tu shtoj këtyre edhe disa mendime të mijat. Jeta është një përzierje kohësh të mira dhe të këqija, çastesh të lumtura dhe të dëshpëruara. Në një çast që ju jeni në një kohë të keqe, apo moment trishtimi, që ju krijon ndjenjën e të qenit gati për tu dorëzuar, mund të përkulni gjurin, por mos u thyeni. Bëni të pamundurën që situata të mos marrë vlerat më të mira prej jush.

Ju duhet të mbaheni, qoftë edhe tek një fije e hollë shprese, që me shumë punë dhe durim, ju mund t'ia dilni mbanë pavarësisht çfarë vështirësish ju kanë dalë përpara. Me shpresën për një të nesërme më të mirë, apo për një situatë më të mirë, gjërat nuk do të jenë aq keq sa ju duken. Keni parasysh se çfardo vështirësi që ju del përpara do ta keni më të lehtë ta përballoni nëse rezultati përfundimtar ja vlen.

Kjo është po kaq e vërtetë edhe në FOREVER. Të gjithë neve ndeshim sfida, dështime dhe diziluzione. Ajo që me të vërtetë na dallon nga të tjerët dhe që na ndihmon të krijojmë madhështinë e vërtetë tek vetja dhe tek të tjerët është aftësia për të vazhduar të shpresojmë tek diçka më e mirë. Ne duhet të besojmë që objektivat tona janë të arritshme dhe se realizimi i tyre do të sjellë një ndryshim të vërtetë si në jetën tonë, po ashtu edhe në jetën e gjithë atyre njerëzve që ne ndikojmë me biznesin tonë – në familjet tona, tek ata që janë poshtë nesh, si dhe tek kolegët distributorë.

Le ta fillojmë këtë vit plotë me shpresë. Unë për vete jam i sigurtë që kështu do ta filloj. Kam besim se 2011 do të jetë viti më i mirë që kemi pasur në Forever. Pse besoj në këtë? Sepse udhëtoj nëpër botë duke takuar me mijëra prej jush. E di se jeni grupi më i distributorëve që kemi patur ndonjëherë. Jeni vërtet të angazhuar dhe të vendosur për të ndryshuar jetën tuaj, si dhe jetën e shumë të tjerëve. Le ti mbushim kështu faqet boshë të 2011-ës me më shumë përvujë dhe suksese, që do ti kujtojmë për shumë e shumë vite në të ardhmen.

Përgjithmonë i juaji,

REX MAUGHAN
CHAIRMAN OF THE BOARD & CEO



Në fillimin e Vitit të Ri

Në shumë shtëpi është ngritur pema e Vitit të Ri, për të na kujtuar çastet e besimit, aromën e bakllavave të shijshme, por ndërkohë edhe fillimin e vitit të ri. Për foshnjat viti i ri do të thotë një botë e re, për fëmijët ca ditë pushime të shkollës, për ne të rriturit mundësi dhe sfida të reja. Një nga elementët më të rëndësishme të kësaj jete është siguria. Të mund të duam qetësi dhe mirëqënie për vete, për fëmijët dhe të dashurit tanë, vetëm atëhere është e bukur kjo botë.

Sigurinë e çvendosim në njërin krah të peshores, por a e dimë sa na kushton kjo? A kemi bërë gjithshka që të mund të jetojmë në qetësi, a kemi sakrifikuar një film serial, që të mund të paguajmë rregullisht faturat tona? A kemi sakrifikuar të lëmë pa marrë pjesë në një „paradë yjesh” që të mund të blejmë disa veshje të bukura e të reja për familjen? A kemi dalë nga streha e ngrohtë për në rrugët e ftohta e me dëborë, që pastaj të mund të ulemi në veturën luksoze e të rehatshme? A ke brënda vetes aq rezistencë e vullnet, që të ecësh deri në fund në këtë rrugë të vështirë?

Këtu, në Forever, vetëm me shumë punë mund të marrësh shpërblimin e jashtzakonshëm, dhe kjo është gjë e mirë. Mund ta matësh veten! Mund ta dish sa i aftë je të rezistosh, të mbash angazhim, të durosh punën dhe të dish sa i do njerzit dhe shokët e tu. Ngase të gjitha këto i ke, atëhere do të kesh vërtet shumë dhurata. Ajo çështje që këtu në Forever as që ngrihet ndonjëherë është ajo që a do ti marr të gjitha këto! Këtu githmonë dhe gjithçka të jepen saktësisht në dorë, qofshin transferta parash, dekorime e vlerësime.

2011 është viti i ripërtëritjes në Europë, në botë por edhe në Hungari. Le të jemi të gatshëm që të mund të rinovohemi, në radhë të parë duke fituar sigurinë tek vetja, por sigurisht edhe tek mjedisi që na rrethon. Ai që e ka provuar një herë, se në çfarë mirëqënie dhe sa të shijon siguria e dhënë nga Foreveri, ai atë do ta dëshirojë gjithë jetën. Po ata që nuk e kanë ndjerë akoma? I kërkon ata dhe bisedoni me ta se çdo të thotë të jetosh sot në Hungari në siguri dhe në mirëqënie materiale. Duaje veten aq sa ti kesh dhënë vetes gjithshka, dhe në çdo çast, në çdo mendim tëndin përqëndrohu tek ata, që akoma nuk jetojnë ashtu si jeton ti apo si do të doje ti të jetonin dhe ndaji me ata këtë mundësi. Mësoi ata me durim, me besim. Bëni plane afatgjatë, planifikoje jetën tënde, sepse nuk është njëlloj, që vitet që të janë dhuruar, që jetën tënde, ta jetosh si ta jetosh apo ta jetosh në mënyrë cilësore. Mund ta jetosh edhe si skllav, ngase ke vendosur që të tjerët të ta drejtojnë jetën dhe të të paguajnë për punën tënde vetëm bukën e gojës, por mund të bëhesh drejtues i vetvetes, ngase do të mund të zgjedhësh lirinë. Jetën tënde mund ta jetosh edhe me shijen e lirisë! Gjithkush e dëshiron lirinë dhe sigurinë. Paçi forcë dhe rezistencë që të mund ta bëni këtë hap. Për këtë ju uroj shumë suksese e lumturi dhe një vit të ri të mrekullueshëm 2011!

Përpara Forever!

2011


DR. MILESZ SÁNDOR
DREJTOR I PERGJITHSHËM



FOREVER Success Day

BUDAPEST, 18.12.2010

I shte vit i vështirë apo i lehtë 2010-ta? Interesante është ajo që ndërtuesit e vërtetë të rrjeteve as që i dëgjojnë pyetje të tilla. Sepse viti është i atillë siç e bëjmë ne vetë. Edhe më përpara ka patur periudha sfidash të mëdha, para 10 vjetësh, para 5 vjetësh...por kudo ku kemi hedhur këmbën në ketë vend nuk ka patur drejtim tjetër veçse në ngjitje , dhe është e vërtetë sepse nqse besojmë në një gjë , aq më e lehtë bëhet ajo.Festimi i krishtlindjeve në Forever na jep energji të mjaftueshme për çdo vit të ri, për çdo muaj të parë të tij.

Kur me pjesmarrësit po kalonim drejt portës së hyrjes, në fillim dukej si diçka misterioze nga ngjyrat e shumta të kuqe.Dukej në veshje, në dekoracion, në buqetat e luleve, dhe pastaj kur edhe brirzat në kokën e drejtuesve të programit atëhrë e shohim vërtet se kemi ardhur në festën e e gëzuar të krishtlindjeve.

Tek pjesmarrsit në festë duken më shumë se zakonisht fëmijë, por edhe të rritur. Por edhe të vegjlit më shumë se programi i fëmijëve i tërheq skena se atje diçka presin. Të rriturit tashmë e dinë , se edhe fëmijët do ti thërrasin në skenë për tu dhënë dhuratat dhe qeskat me sheqerka. Por në fillim treshja ëngjëllore me **Diána Biróm**, **Tünde Hajcsik** dhe **Pátricia Rusák** me kostumet e çuditshme, u drejtohet të rriturve. Sot gjithshka është pak ndryshe. Himni i Foreverit me qëndrat e zërit të reja, shoqërohet live nga grupi **Android** ku **Lajos Turi Lui** këndon bashkë me gjithë anëtarët e Klubit të Presidentit, madje kënga shoqërohet edhe nga gjithë publiku. Duhet të dëgjohet deri në Amerikë „Oh , Happy Day”, të filmuar në mënyrë cilësore me HD do ta shikojnë edhe drejtuesit e firmës në Amerikë se çfarë dite e lumtur është në Budapest.



FESTË NË FOREVER. FJALË FORMIM INTERESANT, E KUR
NUK KA QËNË E TILLË? HERËN E FUNDIT TITULLUAM
DIAMANTËT, QË PADYSHIM ISHTE FESTA E FESTAVE,
AJO ISHTE DITA E SUKSESIT E PERGJITHSHME. AI QË
TASHMË KA HYPUR NË SKENË SI I KUALIFIKUAR, KËTË E DI.
MEGJITHATË RASTI I DHJETORIT ISHTE DIÇKA TJETËR:
MBYLLËM SËBASHKU VITIN 2010

Dhe vërtet s'ka si të mos jetë e tillë, kur për këtë punon një skuadër e tërë, me në krye **Dr.Milesz Sándor**, falë të cilit, „skuadra hungareze ecën në krye të Europës” - thonë drejtuesit e kompanisë.

Shtëpia është mbushur plot, na konfirmon me fjalët e para Drejtori i Pergjithshëm, dhe pastaj thekson se tash u bënë 15 vjet „që Forever Living nga shkelur në tokën hungareze”. Që nga ajo kohë shumë e shumë ton Aloe Vera Gel kemi konsumuar ,duke bërë një punë të jashtzakonshme për jetën, shëndetin dhe të ardhmen tonë” - thotë Dr. Milesz, pastaj me gjysëm shaka nënvizon: paletave të produkteve tona tani i mungon vetëm elixiri i jetës së perjetshme!”

Por sa më shpejt do ta kemi edhe atë, do të na përgjigjet edhe „vëllai i vogël”. Dr Milesz premton para publikut pjesmarrës se në 2011 do të botojë librin „Aloe Vera, bima medicinale më popullore e shekullit 21” Betimin e bërë para disa mijra dëshmitarëve e presim në vjeshtë. Edhe deri atëhere, është me interes që këto njohuri tu trasmetohen të tjerëve, sepse kjo është e ardhmja e këtij vendi, dhe e kësaj bote, ndërsa thesaret e tyre janë fëmijët tanë- thekson Sándor.

Dr. Edit Révész Siklosné - Soaring Menaxhere na tregon se çfarë mund të bëjmë qysh tash që fëmijët t'i drejtojmë në një mënyrë jete të shëndetshme.

Konsulentja mjeke, jashtzakonisht praktike, duke u futur deri në detaje, na tregon se se si duhet të kemi kujdes ndaj faktorëve dëmtues të mjedisit dhe si mund të forcojmë sistemin e imunitetit të fëmijve tanë, dhe nëpërmjet kësaj ti ruajmë ata nga efektet e dëmshme.

Fjala vjen tek produktet më të mira mbrojtse të imunitetit si: vitaminat, antibiotikët natyror, bimët medicinale.





Megjithse sistemi imun i fëmijve parimisht vepron ashtu si edhe yni, nuk bëjmë keq që ti perkrahim ata me një përkujdesje personale. Për këtë ti informojmë drejtpërsëdrejti për rezultatet më të freskëta studimore. Dhe ajo e mbyll me një urim festiv: „Në vënd të dhuratave të shtrenjta, që disa herë nuk u tregojnë asgjë, të gjithë juve ju uroj një trup të shëndoshë, një shpirt të mirë brënda zemrës, një bashkëjetesë familjare plot dashuri”. Para se të jepen distiktivët e Supervisorëve dhe Asistent Menaxherëve, përgatitet një dhuratë befasuese: hidhet shorti për telefonin e provuar si debutim në rrjetin telefonik FLP, Drejtori i Përgjithshëm në prezencë të noterit thërret numurin telefonik FLP të përzgjedhur, dhe nqse i thirruri është prezent në sallë, atëhere fitorja do të jetë e tija: së pari një darkë në restorantin Foleja e shqiponjave, pastaj do të vijojnë edhe dhurata më të çmuara sipas pikave të mëtejshme të programit.

Tash dhurata më e çmuar për supervisorët dhe asistent menaxherët është shtërngimi i duarve me drejtuesit e firmës, për një kohë skena është e tyre. Pastaj vazhdojnë fëmijët, që mund të jenë menaxherët e ardhshëm. **Dr Terézia Samu** dhe **András Bruckner**- Soaring Menaxherë, gjatë gjithë dhjetë vjetëve presin në skenë fëmijët. Sikurse thotë Terézia, „jeta atëhere është e mirë kur pas nesh mbetet dikush”, sepse trashëgimninë tonë shpirtërore pasardhësit tanë e çojnë më tej. Si do të jenë ata, kjo varet nga ne- thotë jmjekja konsulente, dhe pastaj pyet fëmijët se çfarë produktesh konsumojnë rregullisht. „Mjaltë, propolis, Kids, Vitaminë C, Aloe me pjeshkë, Aloe me boronicë, vaj peshku... jehojnë përgjigjet e tyre, herë herë duke i ngatërruar, e herë herë të pasigurtë për emrat e produkteve, por s’ka gjë, do të rriten e do ti mësojnë, ndërsa Plaku i Vitit të Ri nuk bën dallime, ai ka dhurata për të gjithë.





Të gjithë tashmë e kanë dëgjuar justifikimin: „ju e keni pasur më të lehtë, se ju e keni filluar të parët”. Këtyre thenieve kundërpërgjigjen ua jep fjala e mbajtur nga **Rozália Maczó**. Menaxherja ka vetëm një vit që ka filluar ndërtimin e rrjetit dhe thekson se tani na ofrohen më shumë mundësi se në fillim.” tani po vjen vala e tretë. Shumë të rinj presin tu japim objektivat e tyre për jetën, ndërsa ne me një ndjenjë edhe më të lartë mund tu tregojmë atyre se mund të jetohej edhe ndryshe.” - thotë Rozy dhe pastaj me perlogaritje të detajuara na argumenton fjalën e saj kun ë sajë të çmimeve NDP në krahasim me vitin e shkuar tani mund të fitohet 10 herë më shumë.

Në FLP shpërblehen edhe talentet. I vjen fundi garës vjetore dhe serisë të studimit të talenteve të Yjeve të FLP. Një kërcim nga **Anita Reiberger**, pastaj një këngë nga **Évi Sári**, dhe zhuria ka vendosur (por rezultatet u dhanë vetëm në fund të ditës jepen nga drejtuesi i programit **Zsolt Frenkó**. Dhe si për ti dhënë diçka publikut, më

parë **Zoltán Mága**, **Gabriella Berkes**, dhe **Zsolt Frenkó** japin një program më vehte, pastaj grupi vogël duke u kompletuar me anëtarët e tjerë të zhurisë, me **Károly Horváth**, **Attila Pataky**, **Ákos Tihanyi** këndojnë këngën me titull „Prandaj i kemi miqtë e mirë” - Tashmë ndizen dritat vezulluese të pemës të krishtlindjeve. Sot çdo demonstrim i Conquistadorëve dhe menaxherëve të rinj bëhet me melodinë e krishtlindjeve, pastaj **Anikó Kardos** merr mikrofonin. Sikurse shprehet , jo për modesti fallco, por nuk është ësuar me këto, për rezultatet e periudhës së shkuar, ajo falnderon edhe ata që e ndihmuan, sepse duhet shumë durim. Duke u larguar ajo përsëritet „U bëfshi diamantë!”... Pastaj e merr fjalën, e njohura e skenës **Hajnalka Senk-Soaring** Menaxhere që bëri bilancin se si përfundoi ky vit. Ajo personalisht ka të drejtë: „një vlerësim të tillë kurrë nuk e kam patur në vëndin e punës” - thotë ajo, pastaj ua bën të njohur edhe „të rinjve” duke rreshtuar „të ardhurat e panumurta në natyrë”, të cilat nuk merren si dhuratë, por





si një shpërblim i ligjshëm për distributorin. Pastaj ndarja e fitimit Profit Share, udhëtimet, trainimet profesionale, programi stimulues i makinës... që janë elementë të një sistemi motivimi real e të planifikuar mirë, të cilat i kanë provuar shumë ashtu si edhe Hajnalkës pas shumë provash të fatit „ me këtë biznes i ra llojoja e madhe” .

Mendimet e Diamant-Zafir Menaxherit **Róbert Varga** janë koncize. E shkuara, e tanishmja dhe e ardhmja e FLP- e ka titullin biseda e tij. Prej tij mësojmë historinë e përbashkët të Róbit dhe të firmës, jo vetëm për këtë vit, por më gjatë. Firma është zhvilluar kaq shumë sa bashkbiseduesi arrin të kontaktojë edhe nga një kabinë telefonike. Sot realizohet lehtë blerja e produkteve, rrjet telefonik

i firmës, projektor, përdorim i internetit, po të përmendim vetëm disa nga lehtësirat, ndihmojnë punën edhe në mënyrë të pavarur të 8000 mjekëve specialistë. Duhet sqaruar që në fillim –thotë Róbi – se „Aloe është bërë e evidente”, që në situatën ndërkombtare financiare të sotme e konsideron si një trampolin, mbasi „janë 600 000 vetë që kërkojnë sponsor në biznesin e FLP, dhe po bëhet rindarja e tregjeve”. Si mbyllje falënderon ata që e kanë ndihmuar , pastaj prezanton librin e shkruar për këtë. Prova më shumë se kaq ndofta nuk duhen për mundësitë që ofron FLP-ja, Përsëri shorti telefonik, ku si dhuratë do të ketë një udhëtim luksi 7 ditor vet i dytë në Turqi dhe në Kenia, por nuk shkon lehtë, sepse dikush është larguar para kohe nga Dita e Suksesit dhe kështu humbi dhe shansin sepse Drejtori i Përgjithshëm quan fitues vetëm atë që përgjigjet brenda stadiumit Arena. Dr Milesz, krahas fituesve me fat, ju uron të gjithë distributorëve të FLP, Bekuar festat! Dhe s'ka





dysim duhet të jemi prezent, në çfardo kuptimi, kur njeriu ëndërron një jetë të re. **Jozsef Szabó**, ai që pa i pari në Hungari në ëndërr Aloen, tashmë është Zafir Menaxher. Risjell në kujtesë rrugën e gjatë, duke filluar nga koha kur u takua për herë të parë me **Rex Maughan**. „Ky biznes nuk do të funksiononte nqse nuk do të ishin njerzit që përfaqsojnë vlerat ashtu si edhe unë në kohën time. Janë ata që e dinë, se ja vlen të jetosh me ndershmëri dhe pastërti. Ky grup produktesh nuk është gjë tjetër, si një media ndërmjetëse e çuditshme ndërmjet njerzve, dhe personalitet do të bëhet ai që vendos , do të vijmë me ne të tjerët apo jo”. - thotë themeluesi, nga zemra e të cilit shprehet edhe ajo se me sa kënaqsi e pritë: po paraqitet brezi i ri i cili do të marrë edhe stafetën e përditshme. Mos u mërztitni thotë ai ”unë nuk betohem që unë do të jem më i miri, por që këtë do ta përfaqsoj sipas aftësisë të mija më të mira. Edhe një herë po ta filloj, po atë do të bëj deri në

fund.” – nënvizon Jozsef Szabó, por shikimi tek e shkuara atëhere ka kuptim kur sytë i kthejmë nga viti që vjen dhe më poshtë vazhdon „S’ka rëndësi nga ke ardhur dhe çfarë ke bërë deri tani. Nqse bashkohesh me ne , kape mundësinë, që të ndryshosh dhe prej diamantit të pagdhundur do të kesh një xhevair të vërtetë.” Sipas traditës si pikë e fundit e programit vazhdon kualifikimi i asistent supervisorëve, por para kësaj Dr Milesz Sandor thërret në skenë ekipin, punonjësit e FLP Hungari dhe Phónix Budapest, duke i falnderuar për punën e përkushtuar gjatë gjithë vitit.

Fituesit e çmimeve të konkursit të talenteve Yje të FLP

KATEGORIA KËNGË E MUZIKË:

Vëndi i I-rë: Hungaricum

Vëndi i II-të: Évi Sári

KATEGORIA BALETIT:

Vëndi i I-rë: Anita Rieberger

Vëndi i II-të: Starlight Dance Company

ÇMIME TË VEÇANTA:

Ádám Sólya, Istvánné Réhm, Ildikó Tas

Fituesit në vartësi të çmimit do të kenë:
Darkë ekskluzive në Restorantin Foleja e Shqiponjave (Sasfészek) , wellness në weekend në kështjellën e Szirákut , dhënie koncerti, mundësi të prodhimit të CD





Dita e suksesit dhe ditëlindja e FLP Kroaci

6.11.2010

TASHMË 11 VJET MË PARË U HAP ZYRTARISHT ZYRA E FLP NË KROACI. NJË RRUGË TË GJATË KEMI LËNË PAS. BASHKË U ZHVILLUAM, MËSUAM, U MIQËSUAM, U GËZUAM PËR SUKSESET E NJERI TJETRIT DHE NDIHMUAM E NXITËM NJERI TJETRIN. PAS 11 VJETËSH ME FORCË TË PANDRYSHUESHME JEMI NË MIQËSI DHE DUKE MËSUAR NGA NJERI TJETRI. MUAJI TETOR KA NJË RËNDËSI TË VEÇANTË NË JETËN E FLP KROACI. LE TË KTHEHEMI 11 VJET PAS NË MENDIME, NË HAPJEN FESTIVE TË FLP NË HOTEL SHERATON TË ZAGREBIT. PAS KËNAQISË DHE FRYMËZIMIT FILLESTAR ME KOHË NA HYRI DËSHIRA E ECJES PËRPARA.

Çdo ditëlindje është një ditë e shënuar, por nëse sukseset dhe miqësinë tonë i kujtojmë si simbole të saj, objektivat na duken më afër, e tanishmja dhe e ardhmja bëhen më të bukura. Të gjithë ata që janë prezent i rëndësor fryma e gëzuar dhe pa mjegullnajë, dhe kjo energji pozitive si orientues na tergon të gjithëve rrugën drejt objektivit përfundimtar, - drejt suksesit. Vitin që shkoi me rastin e ditëlindjes të firmës hapëm zyrën e re në Rjeka, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës të rrjetit që vepron në atë qytet dhe rrethinat e tij, sepse pa asnjë përjashtim kolegët tanë në bazë të rezultateve të tyre e meritonin këtë.

Me këtë rast do të doja të falënderoja personelin teknik dhe bashkëpunëtorët e tyre në televizionin e FLP Hungari për ndihmën që dhanë për organizimin dhe mbështetjen teknike në aktivitetin e krijimit të FLP Kroaci.

Në Hotel Adriatik të Abbazia-s bashkë me ditën e krijimit u festua Dita e Suksesit - ku me prezencën e tij nderoi **Dr Sándor Mílesz** - Drejtor i Përgjithshëm për Hungarinë dhe Ballkanin.

Drejtues të Ditës të Suksesit ishin **Sonja** dhe **Zlatko Jurović** - Senior Menaxherë të Rjekës, të cilët kanë shtrirë krahun për tu bërë Soaring Menaxherë. Suksesi i tyre qëndron në atë që ata kanë punuar njëloj si me ata me mendim pozitiv ashtu edhe me ata që kanë qënë të lëkundur, duke qënë në gjendje të motivojnë edhe këta të fundit. Sonja dhe Zlatko përshëndetën të gjithë me rastin e ditës





të krijimit të FLP , falnderuan miqtë dhe bashkëpunëtorët dhe pastaj ftuan në skenë Drejtorin Rajonal të Kroacisë – që tashmë prej 11 vjetësh drejton me sukses FLP Kroaci, dhe i cili vetëm duke punuar në FLP për punën dhe zellin e tij ka marrë vlerësimin e vërtetë. Në veprimtarinë e tij ka që shumë i sukseshëm edhe si ndërtues rrjetesh, duke arritur Senior Menaxher.

Mr.sc László Molnár – duke u ngjitur në skenë- shprehu kredon e tij sipas të cilës „jetojmë nga FLP dhe për FLP.”

Falnderime shprehu ai për **Agnes Krizsó**, e cila ngriti dhe nisi për udhëtim skuadrën e Fiumes, **Dr. Albert Keresztényin** dhe tërë skuadrës të tij , që po kryejnë një punë të shkëlqyer në Rjeka , në Istria dhe në rivierën e Kvarnerit. Gjatë bisedës të tij ai bëri të njohura rregullat e reja të sistemit të risponsorizimit, qëllimi i të cilave është zgjimi i distributorëve që kanë rënë në gjumë.

Zoti Drejtor Molnár ftoi në skenë vizionarin e madh të FLP, njeriun që guxoi të ëndërronte dhe të parashikonte atë që për ne dukej e largët dhe e paarrtshme. Falë atij ne u bëmë të parët në Europë dhe të tretët në botë-ai është Dr Sándor Milesz.

Dr Milesz përshëndeti me rastin e ditës të lindjes të FLP Kroaci, duke falënderuar për punën e bërë në 11 vjetët që shkuan.

Një skuadër futbollit përbëhet nga 11 pjestarë. Të gjithë jemi anëtarë të njëlojtë të skuadrës. Tashmë vetëm një çikë na pengon, që të bëhemi edhe më të fortë në rajon. Kjo varet pikërisht nga ne, në atë që duhet të ndryshojmë. Koha kalon, ndërsa ne duhet të bëjmë më shumë për të qënë të gëzuar. „A e keni caktuar tashmë rrugën tuaj? Mund të bëheshit edhe më të mirë, duke u bërë pjesë e skuadrës. Do të doja ta udhëhiqja në fitore këtë skuadër kroate, ku ju të jeni udhëheqësit e saj, ndiqni ata në rrugën e filluar nga ne - mbylli fjalën e tij Dr. Milesz.

Nqse dikush i ofron mundësitë e biznesit atij që nuk di gjë fare për MLM, ai i ka të vështira gjërat. Gjithshka duhet ta bëjë vetë, duhet ti provojë gjërat, të cilat nuk ka me se ti mbështesë. Këtë e ka kaluar edhe njeriu që solli 11 vjet më parë FLP në Kroaci. Në Kroaci nuk kishte as zyrë, as produkte , as lektorë, asgjë prej gjëje. Vetëm ai ishte. Dhe për të sakrifkoi personin e tij, që të bëhej motori i gjithë atyre që e besuan në Kroaci. Parrulla e tij ishte: Forca Fiume. E

gjithë skuadra e ndoqi atë, dhe ai gjithmonë ishte në dispozicion të tyre. Ky ishte Dr Albert Keresztényi. Ai shpreh falnderime 15 pjestarëve të skuadrës që udhëheqin shumë të tjerë. Këtë skuadër e përbëjnë: familjet **Stilin, Jurović, Pavletić, Golubović, Korenić, Miljak, Draščić, Lesinger, Iskra, Grbac, Žantev, Petrović, Banić dhe Badurina**. Ndiqni ata bën thirrje mesazhi i **Z.Albert**. Pastaj Alberti vazhdon bisedën me temë mjekësore duke trajtuar lidhjen e produkteve të FLP me fëmijët, me problemet e mbetjes me barrë, periudhën e barrës dhe çështjet e foshnjës.

Në ekspozetë e paraqitura gjejmë produktet që u përgjigjen të gjitha periudhave. **Dr. Branka Molnar Stantić** drejtoi bllokun që bënte fjalë për përvojën e konsumatorëve. Në këto biseda u vlerësuan sinjalizimet që vijnë nga konsumatorët, ku për të cilat duhen specialistë- mjek që tu tregojë avantazhet e këtyre preparateve. Ndoshta Dr. Molnár e njehtë më mirë mekanizmin e efektit të preparateve tona, dhe me njohuritë dhe këshillat e tij thelloi njohuritë tona, i plotësoi ato me përvojat tona, të cilat distributorët konsumatorë i ndanë me ne.





Pas kësaj vazhdoi demonstrimi i kandidatëve të konkursit të bukurisë për titullin Miss Sonya e Kroacisë. Shtatë vajza me bukuri prrallore demonstruan me rroba mbrëmjeje ceremoniale dhe me makiazhin Sonya. Zhuria e përbërë nga **Ágnes Krizsó, Andrej Kepe, Branislav Rajić** dhe **Dr. Slavko Paleksić** e patën të vështirë të zgjidhnin 3 më të bukurat.

Mjekja e re nga Bjelina, **Sanja Ljubojević-Milovanović** falnderoi për ndihmën e sponsorave dhe për mikpritjen kroate dhe pastaj foli për kozmetikën e e bukurisë Sonya. Shpesh nënvlehtësojmë kujdesin për lëkurën, kur lëkura përbën vijën kufitare midis pamjes së jashtme dhe organeve të brendshme të trupit. Ajo, se sa plakemi varet nga raporti i brendshëm dhe i jashtëm me lëkurën. Xhelet tanë janë jashtzakonisht të mirë, plotsuesit tanë ushqimore freskojnë dhe ushqejnë, ndërsa kozmetika jonë përgatitet nga lëndë me bazë bimore dhe nuk ka lëndë inerte apo aromatizues të tepërt. Pas kësaj hyrje të shkurtër Dr. Milovanović prezantoi lektoren pasuese të Sonya Show, valltaren e re popullore, Menaxheren **Szilvia Széplaki**, e cila bashkë me katë valltare të tjera, na tregoi se si me sa pak ndihmë mund të bëhemi të tilla, si yje kinemaje. Me pak vëmendje dhe përkujdesje dhe me produktet e FLP mund të arrijmë rezultate maksimale. Shampon, kremërat dhe makiazhet, të gjitha i sjell FLP, ndërsa specialistët e kozmetikës ndihmojnë me këshillat e tyre.

Soaring Menaxherja **Diana Biró** spjegoi cilat janë ëndërrat e saj. Pak më e guximshme se sa do të guxonin të ëndërronin shumica. Fton në skenë kozmetistët dhe masazhierët që bëjnë prezantimin e dy modeleve, pastaj vazhdojnë kozmetistët dhe parukieret që duke bërë çudira të verteta, magjepsin me modelet e yjeve. Duke u larguar nga skena, Diana premtan se edhe në të ardhmen do të vijë në Kroaci, me akoma edhe më shumë këshilla. Prezantoi gjithashtu menaxheren **Borbála Székely** e cila u shpreh se çdo grua mund të bëhet star në jetën e vet. Për këtë nuk duhet gjë tjetër, përveçse pak bërje të mirë flokësh, pak makiazh dhe diçka që ta ndihmojë nga brenda organizmit. Të afrojmë rreth vetes njerëz që i duam, të lozim sport, dhe të mbajmë qëndrim pozitiv!

Pastaj vazhdoi anëtarja e perhershme e Klubit të Sundimtarëve, **Dr Adrienn Rokonay**. Na bën të ditur se pas plotësuesve dietikë, filloi kremrat dhe kozmetikën Sonya. Brenda një kohe të shkurtër arriti rezultate spektakolare, që i forcoi besimin në vetvete. Gjithnjë e më tepër gratë kërkojnë kozmetikën bimore, dhe këtë ua ofron atyre FLP-ja.

Po cili është stili i jetës të Diamantit- këtë na i tregon **Stevan Lomjanski**. Ai ka provuar dhe po bën jetën e Diamantit. Stevan Lomjanski përshëndet të gjithë pjesmarrësit – valltarë, valltare e lektorë, që çfaqen të bukur e të lumtur. Çdo grua mund të jetë e sukseshme njëloj si në profesionin e saj

ashtu edhe në ndërtimin e rrjeteve. Prova më e mirë jeni ju, sa shumë mundësi ju ofron FLP. Të gjithë synojmë që sa më tej shkojmë aq më të rinuar të shfaqemi. Sot shumë pare qarkullon në industrinë kozmetike, por edhe kozmetika jonë bimore dhe plotsuesit tanë ushqimorë janë të persosur.

Eduard Badurina, është menaxheri më i ri i Kroacisë. Me partneren e tij **Tea**, zgjodhën këtë jetë mbasi zbuluan shpejtë mundësitë që fshiheshin në të. Midis pozicionit të menaxherit të një firme prestigjioze dhe FLP, at zgjodhën FLP. Ai tregoi se si mori vendimin, si u bënë sponsor të sukseshëm nga Nedjeljko, me ndihmën e sponsorve të linjës së sipërme **Sonja** dhe **Zlatko Jurović**. Dhe për të nuk ka ndalesë, e ardhmja e tij është qielli me yje.

Menaxheri **Ivan Lesinger** gjithë jetën e tij ua ka kushtuar bimëve. Ai është autor i disa librave, i ftuar i shpeshtë i programeve radiotelevizive. Ivani pas kësaj u angazhua në marketing, na drejtoi në këtë biznes, si të bëjmë punën, si të ndjekim sponsorit tanë dhe si tua trasmetojmë mesimet bashkpunëtorëve tanë më poshtë. „Bëhuni këshilltarë dhe jo lektorë- thotë ai”. Gjejini edhe ju qëllimet dhe motivimet tuaja në FLP”. Kur do ti gjeni, nqse nuk i gjeni sot, dhe kush do ti gjejë nqse nuk i gjeni ju” e perfundon fjalën e tij Z. Leisinger.

Pas kësaj vazhdon titullimi i supervizorëve, asistent menaxherëve, menaxherëve dhe Sundimtarëve. Qe gjë e bukur që pas një





kohe të shikoje përsëri të mushur plot skenën me të kualifikuar, që arritën këtë nderim, dhe që simbolin e vlerësimit të tyre ta merrnin personalisht nga dora e Dr Sándor Milesz.

Sonja dhe Zlatko prezantuan sponsorit e tyre **Maja** dhe **Tihomir Stilin**. Ata na spjegojnë se mund të ndërtosh një skuadër të sukseshme, sepse ata janë fitimtarë. Na treguan se si e filluan dhe si e vazhduan rrugën e tyre plot pasiguri. Në fillim pasiguri, pastaj investim i një pune të madhe dhe përfundimisht arritje e objektivave. Eshte e pamundur pa reformuar veten, sepse faktori më i madh që pengon jemi ne vetë. „Nqse mund vetveten-atëhere ke hyrë në rrugë të drejtë!” - thonë ata dhe nuk e kanë gabim. Në bazë të FLP ndryshoi jeta e tyre.

Lektori tjetër është i angazhuar me biznesin e FLP që prej 10 vjetësh. Gjithmonë ka sulmuar për atë që i ka ofruar FLP. Eshtë një figurë kyçe, dhe si mund të bëhet kushdo ashtu- na i spjegon në fjalën e vet **Jadranka Kraljić Pavletić**. Mos është vallë njeriu kyç ai që mban kyçin?. Apo më shumë është ai që guxon më shumë... të hapë... vetveten? „Nqse mbylleni në vetvete, në mendimet tuaja, askush nuk mund tju ndihmojë, gjithshka varet nga ju vetë. Merrni pranë vetes atë që u përket nga thesari i FLP. Hapeni veten!” – thotë mesazhi i Jadrankës Tek lektori që pasoi u fiksuam në mënyrë të vecantë, mbasi në takimin e menaxherëve gjithnjë ka përforcuar skuadrën kroate të

futbollit. **István Tóth** nuk kërkoi skuadrën më të fortë, por ai u kap tek ata që kishin nevojë për ndihmën e tij. Puna e tij e tillë ka qënë, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar. István Tóth – Soaring menaxher na bëri të njohur mundësitë e reja të fitimit nëpërmjet çmimeve të distributorit të ri (NDP). Këto janë mundësi fitimi financiar për atë që sapo ka filluar ndërtimin e rrjetit. Sa kohë i kemi kushtuar, sa njerëz kemi thirrur, po cili ishte rezultati? Po fitimi mesatar mujor. Gati disa orë në ditë, disa ditë në javë. Po çfarë na pengon që të marrim paratë që na ofrohen? Shfrytëzoni mundësitë. Bëni më të lumtur veten dhe bashkëpunëtorët që ju ndjekin juve.

Jepet rezultati i konkursit Miss Sonya Kroaci për në finalen e Hungarisë. Vandin tonë do ta përfaqësojë fituesja, e cila shoqërohet nga shoqërueset e Misseve Mariana dhe Petra. Përhëndetje! **Ágnes Krizsó**, Zafir Menaxhere, krijoi rrjetin e Rjekës. Krahas doktor Albert Kerestenyit është ajo që bëri linja e Rjekës të jetë linja më e fuqishme në gjithë Kroacinë. “Kroacia është atdheu im” shprehet ajo me fjalë të ngrohta. Ágnes gjithmonë ka pasur ëndrra, por i duheshin njerëz të tillë, që ta përkrahnin në realizimin e këtyre ëndrrave. “Dashuria dhe shikimi i lumtur është dhurata më e madhe.”

Vazhdon diamanti i parë i rajonit tonë, zonja më e sukseshme FLP-së. Ajo ndërtoi biznesin e saj në një vend të tillë, ku situata ekonomike ishte më e keqja se në çdo

vend tjetër, por asnjë gjë nuk mundi ta ndalonte. Si mund të bëhemi menaxherë, si mund të realizojmë pavarësinë financiare, si të planifikojmë dhe të rrisim cilësitë tona, pyet ajo dhe pastaj përgjigjet: “shmangini njerëzit që kanë në majë të gjuhës justifikimet, me ata veçse humbisni energjitë. Sepse në FLP duhet një punë shumë e madhe, por ajo edhe të shijon. Të punojmë më shpesh dhe më shpejtë me të tjerët.” Ajo jep recetën më të thjeshtë të suksesit. “Kini besim tek vetja! U besoni sponsorëve dhe bashkëpunëtorëve tuaj dhe do të keni sukses!”

Në fund të festës László Molnár thirri në skenë lektorët dhe i falënderoi ata për punën e tyre. Prezantoi bashkëpunëtorët e zyrës së FLP-së në Zagreb, si dhe i falënderoi ata për punën plotë sakrificë. Në përfundim të aktivitetit Drejtori Rajonal u dorëzoi distinktivët bashkëpunëtorëve të kualifikuar si asistentë supervizorë, duke u nisur me këtë për një rrugë edhe më të sukseshme. Skena u mbush me fytyra të reja të rinjsh, të cilët me praninë e tyre e bënë më të veçantë këtë ditë. Miqësia jonë vazhdoi me darkën në restorantin e Hotel Adriatikut, e shoqëruar dhe muzikë e valle.

Deri në takimin e 26 Shkurtit në Rjeka, ju dërgojmë përhëndetje tona duke i uruar kujtëdo suksese në punën e tij.

Mr. sc. László Molnár
Drejtori Rajonal i Kroacisë



ATTILA DHE KATI GIDÓFALVI „E DIMË SE ÇFARË DUAM”



Ju , besoj i keni kërkuar me vetëdije mundësitë e MLM?

Attila: Ashtu është. Ky është një vendim i marrë nga ne. Në bazë të një përvojë 14 vjeçare në punë në rrjetet, ne zgjodhëm Foreverin. Pikëpamja kryesore që gama e produkteve dhe plani i marketingut të FLP. U ulëm të bisedonim me Miklos Bérkics dhe pastaj ramë dakort edhe me Drejtorin Operativ të Europës Péter Lenkey: vallë a përshatet strategjia jonë me konceptin e FLP.

Marrëveshja juaj reciprokisht mund tju jetë dukur një biznes i mirë. Ju tashmë kishit ndërtuar një nga rrjetet më të mëdhenj në botë.

Attila: Kishim ndërtuar një rrjet në një firmë tjetër multi-level në Ukrainë, Rusi dhe Rumani, pra kishim edhe një përvojë të bollshme.

Rezultat shumë i mirë, megjithatë ju desh të ndryshonit. Pse?

Attila: Në fakt për këtë nuk mund të përgjigjemi.

Duket që kishte të ardhura të fuqishme...

Attila: Po, bëhet fjalë për të ardhura mujore mbi 10 milion forinta, që nga njëri çast

31 VJET SË BASHKU, 16 VJET NË MLM, 2 VJET E GJYSËM NË FOREVER. PËR GJITHKËND KJO KOHË ËSHTË MJAFT, EDHE PËR GIDÓFALVËT AJO ISHTE MJAFT, QË TU PËRKISNIN MË TË MIRËVE TË BOTËS, DY HERË NJËRA PAS TJETRËS.

në tjetrin i humbisim, kur u tërhoqëm mënjani. Atëherë objektivi ynë ishte i thjeshtë: të ndërtojmë edhe një herë një rrjet të paktën po aq të madh por me një firmë të tillë ku cilësia e produkteve të ishte e padiskutueshme dhe ku mund të sillnim ndryshime cilësore në jetën e njerzve. E dinim se çfarë donim, por edhe atë se si mund ta arrinim, dhe për mbështetjen e sigurtë të FLP dhe të Miklos Berkics si sponsori ynë.

Sikurse i premtove vetes, gjatë 2 vjetëve u bëtë distributorët me rrjetin më të madh në Rusi dhe Kazakistan, ndërsa këtë rezultat prisni në fund të vitit edhe në Ukrainë. Erdhën me ju anëtarët e rrjetit të mëparshëm?

Kati: Jo, nuk sollëm askënd, gjithshka e ndërtuam nga e para, dhe bashkëpunuam vetëm me ata njerëz që na kërkuam.

Foreveri ju realizoi shpresat që patët tek ajo?

Kati: Shumë, personalisht dhe familiarisht shumë më tepër se sa ishim mësuar. Këtu e vlerësojnë distributorin, jo thjesht si një numur kodik në sistemin kompjuterik. Ndërsa cilësia e produkteve është mahnitëse dhe efekti i tyre pozitiv shikohet shpejt.

Që në 6 mujorin e parë ju realizuat 5000 pikë duke u bërë absolut për çdo rekord, dhe keni arritur një xhiro mujore mbi 10 000 pikë! Dhe në botë u bëtë më të shpejtët që për 2 vjet e gjysëm të arrini nivelin e diamantit.


Attila: Dhe vetëm tani kemi filluar (qesh).

Këto rezultate kanë bërë një jehonë të madhe.

Attila: Nuk e di... jam krenar për atë që kemi arritur, por se çfarë thonë të tjerët për këtë, kjo pak rëndësi ka. Psh nuk eci me veturën Bentley që të më shohin të tjerët, por sepse e ndjej kjo më shkon dhe sepse do të doja të isha shëmbull i FLP në botë.







Nga e gjetët sigurinë në vetvete , që e dije që më përpara: se atje ku u futët, atje do të ishte midis të parëve?

Attila: Ndofta objektivat tona janë më të larta se të tjerëve dhe besojmë se do tu përkasim më të mirëve.

Kati: Ndofta edhe nga ajo se që në femini kishim dëshirë për gjithshka, që nuk mund ta merrnim, ndërkohë që i ishte dhënë tjetrit. Nga kjo rrjedh një farë force kokëfortë. Gjithmonë brënda nesh ekzistonte dëshira për të qënë të pasur.

Dhe ty kush të vuri në lëvizje?

Kati: Të ardhurat si e drejtë autori, premtimi për një të ardhme të parashikueshme dhe që si do që të ndodhë nuk do të drejtohem nga të tjerët.

A mund të na jepni një recetë për një sukses të tillë rekord?

Attila: Mund të jepet dhe mund edhe të mësohet. Vetë se shpesh njerzit prishen. Shumë do të donin të jetonin më mirë, por kjo në vetvete është pak. Për këtë duhet angazhim, që kur mbaron në orën 5 punën që ke , të mos nisësh për në shtëpi por të ndërtosh këtë biznes. Çmimin e suksesit duhet ta paguash, shumica nga ne duhet të ndryshojmë dhe ndofta kjo është më e vështira.

Kati: Plus kësaj duhet përvetsuar MLM-ja, se rezultatet janë në drejtim faze me punën e kryer.

Attila: Ky është profesion, nuk është përrallë. në çdo profesion ka specialistë të mirë dhe të këqinj! Ne ta mendojmë veten rrjetndërtues të mirë.

Thatë se shumë prishen. Me çfarë e prishin më shumë?

Attila: Nuk dinë të fokusohen tek objektivi, nuk kanë rezistencë, nuk ngjiten si duhet me endërrat e tyre. Marrin tre përgjigje jo dhe thyhen. Neve shtatëdhjet e shtatë kandidatët e parë na thanë jo. mund të dorëzoheshim, por kishte shëmbuj pozitiv para nesh, drejtues të tillë që i kishin shkuar deri në fund kësaj rruge. Rruga që të çon tek objektivi është e shtruar me gurë „jo”, dhe vërtet të sukseshëm mund jenë ata që

kanë besim tek vetja. Dhe sigurisht janë produktet , që të ndihmojnë për të bërë një jetë më të mirë dhe më të shëndetshme.

Kati: Thonë se ne tani e kemi të lehtë. Por në fakt sa më lart të ngjitesh në nivel aq më e vështirë bëhet. Edhe ne mund të dorëzoheshim, por nuk kishim zgjedhje tjetër.

Attila: Para kësaj si tregëtar makinash kisha një të ardhur prej një milion e gysëm forinta në muaj, dhe tjetër asgjë. Katika ishte shitse bizhuterish, por sot në Hungari nuk besoj se ciladoqoftë ti afrohet asaj në të ardhurat. Sot kam hotelin tim, 3 restorante, , një fabrikë veshjesh, apartament, por nga asnjëra nga këto nuk kemi arritur të bëjmë ndonjë pare të. Nërsa këtu nqse e e ndërton mirë rrjetin, atëhere ta shpërblen. Familjet kanë nevojë për këto produkte, dhe të rrisin nivelin e xhiros ditore. Kështu nqse e ndërton mirë biznesin e FLP, ai nuk çahet as me tank.

Këtij i duhet një themel i fortë.

Attila: Sigurisht. Puna në marketingun në rrjet (MLM) në fillim gjithmonë është e vështirë. Ka një ritëm që duhet ti rezistosh dhe duhet njohur karakteristikat e veçanta të kësaj sipërmarrje. Së pari fillion të realizohet ëndërra e një familje të vetme , por nqse tërheq disa qindra vetë atëhere fillon të punojë edhe ëndërra e tyre, kështu rezultati rritet në mënyrë eksponenciale. Vetëm se dëshirat ndryshojnë, ka nga ata që ëndërrojnë për 5 milion forinta, ka nga ata që dëshirojnë 10 milion. Ne tani akoma nuk fitojmë shumë, çdo muaj 15 milion forinta. Duhet kohë që të thellohem në këtë biznes dhe të kemi të ardhura edhe më të mëdha.

Keni në mendjen tuaj, një shumë për të cilën do të thoshit, se është jmjaft?

Attila: Nqse do të fitoja 30 milion do ta ulja pak tempin. Sigurisht do të qëndroja aktiv, por nuk do të udhëtoja çdo javë jashtë për të punuar. Në këta dy vjet e gysëm zor se ka patur fund jave që të kem qënë në shtëpi. Unë në Rusi, ndërkohë që Katika ka qënë në Kazakistan, Ukrainë apo Estoni... kështu ka funksionuar.

Si është bërë biznesi juaj kaq ndërkombtar?



Attila: Këtë e ka sjellë jeta. Dikush njihet dikë, që njihet edhe ai një tjetër, kështu mbrritëm në Ukrainë, dhe tashmë prej andej jemi përhapur edhe më tej.

Gjithë kjo në çfarë gjuhe komunikimi?

Attila: Në fillim me përkthyes, por pastaj krahas gjermanishtes mësova edhe anglisht e rusisht.

Cila është rruga më e largët që ke bërë për çështje pune?

Attila: Kabarovsk, duke e shtyrë kohën për 9 orë. Shkoj 2 herë në muaj..., nqse ke një objektiv tëndin, gjithshka e vë në vartësi të atij objekti, por edhe kompiuteri e celulari ta lehtësojnë punën shumë. Dikur vetëm një çdo 20 shtëpi kishte telefon, ndërsa sot flet falas me Skype në çfardo pike të botës.

Çfarë drejtuesi ju konsiderojnë?

Attila: Nuk e di! Ne jemi më shumë të përqëndruar tek rezultati- të fiksuar tek paraja. Punojmë vetëm me atë që ka ëndërra.

Kati: Attila është racional, por ka edhe zemër të madhe, në një farë mënyre di ti kombinojë mirë ato për të cilat njeriu ka nevojë.

Si i ndani detyrat tuaja?

Attila: Secili bën gjithshka, siç ia sjell situata. Të dy mësojmë, të dy zhvillojmë biseda, motivojmë të tjerët, por kati bën edhe prezantimin e produkteve.

Kati: Unë jam më e duruar me njerëzit që nisin nga e para., kurse atila di të motivojë më mirë drejtuesit e rrjeteve.

Dikur ju është dashur të motivoni edhe njeri tjetrin ?

Kati: Jo. Nqse ndonjëri nga ne do të humbiste qejfin për punë, mjafton të shikojmë përreth. Të gjithë ata sipërmarrës që jo shumë kohë më parë kanë fituar parë të pabesueshme, tani gjatë krizës të gjithë janë në hall. Ndërsa sistemi marketingut në rrjet (multi-level) funksionon ndryshe.

Çfarë mendoni për opinion që paraja nuk është gjithshka nqse nuk të lumturon?



Attila: Nuk mund ta identifikoj me atë. në jetën tonë personale, paraja është shtylla bazë e lumturisë. Ajo do të thotë komoditet, ekzistencë, pra gjithshka. Kur u martuam nuk kishim as ujë në shtëpi, laheshim në banjon e ndarë me një perde

Kati: Pastaj relativisht sipërmarrës relativisht mirë dhe me shtëpi familjare me dy makina të mëdha, pastaj prap të varfër, pastaj shumë dhe mund të them se në periudhat më të mira shumë më të pakta ishin stresi dhe konflikti. Sigurisht ia vien të punosh në atë mënyrë, që edhe të mund ta shijosh jetën dhe sistemi i shpërblimit pjesmarrje në udhëtime etj të organizuara nga FLP ta jep tamam këtë mundësi.

Do të donim të arrinin në atë gjëndje që gjysmën e vitit të punonim ndërsa gjysmën tjetër ta kalonim në shtëpinë tonë në spanjë

Po ç'është Spanja për Katin?

Attila: Sporti me motor. Që nga moshja 13 vjeç merrem me mpotorat dhe kam hapur një sallon Harley. Për mua a inuk është vetëm një dyqan , por edhe një mënyrë jetese. Jam kryetar i H.O.G. Nyir.chapter, çdo weekend shetisim, dhe çdo vit shkojmë në turne. Përshkojmë autostradën 66, Korsikën Spanjën...ndërsa në dimër atje bëjmë sport me motorra në dëborë.

Miqësoi lehtë?

Attila: Kur është fjala për qejf e programe argëtimi gjithmonë gjënden shokë. Ndërsa mik kemi vetëm një! Për mua kjo fjalë nënkupton atë që edhe kur nuk takohesh prej një viti, të mund të vazhdosh po ashtu sikur jetoni përditë bashkë. Miku mbetet mik edhe në hall, dhe kjo mund të thuhet për pak vetë. Mua në pergjithësi më shfrytëzojnë.

Kati: Duhet të jemi të vetëdijshëm se njerëzit gjithmonë motivojnë interesat e veta. Unë në

pergjithësi i ndjej prapa qëllimet dhe për kujdes, njerëzit i lejoj të afrohen deri në një farë distance.

Attilan e ke afruar ti më shumë...apo ai ty?

Kati: Jemi njohur qysh në shkollën e mesme një mbasdite në një klub, por 3 vjet më vonë unë ju afrova. Më pëlqente stili i tij, syri, rrezatimi. E ndjeva se ky ishte djaloshi që më duhej. Jemi me fat që u njohëm që të rinj, dhe kështu paralel u formua personaliteti ynë dhe që më lehtë tia tolerojmë gjërat njeri tjetrit, megjithse jemi antipod të njeritjetrit. Por natyrisht rruga jonë është një.

Vajza kujt i ngjan më shumë?

Kati: Babait, vetë se ajo është modeste. E bukur, e mirë, inteligjente.E duam shumë.U diplomua si ekonomiste, ndërsa sot punon si menaxhere në FLP. E pa shëmbullin që me këtë biznes mund të kesh sukses. Në korrik patëm dasmën e martesës të saj që e bëmë në kështjellën e Szirakut. Përveç të afërmëve në listën e të ftuarve ishin edhe sponsorit dhe menaxherët e linjës time direkte.

Attila, ishit i prekur që me ty në festën e titullimit Diamant ishin edhe prindërit tuaj.

Attila: Ata mbeten njerëz të thjeshtë gjithë jetën, vërtet që as do të mund ti kuptojnë sukseset e mia. Ndjej vetëm atë që munda ti ndihmoj të shetit botën me mua, megjithse nuk e prisnin. Mendoj se prej tyre kam trashëguar gjithshka të mirë.

Kati, po ju çfarë do të dëshironit?

Kati: Do të kisha qejf të rinovija shtëpinë dhe sigurisht të udhëtoja sa më shumë nëpër botë! Në tërësi një jetë pa halle.

Attila: Për një të ardhme të tillë, ku të fitojmë aq sa paraja të mos jetë më faktor.



Success Day

LJUBLJANA, 27.11.2010

**PËR SHUMË VETË SOT
ËSHTË VËSHITRË, QË NË
FUND JAVE TË BËJNË NJË
VIZITË TEK PRINDËRIT QË
JETOJNË DISA KILOMETRA
MË TUTJE. NDËRSA NE
TASHMË PREJ KOHËSH
NUK I LLOGARISIM
KILOMETRAT QË BËJMË
KUR NË NJË VËND TË
CAKTUAR NA PRET
FESTIMI I PËRBASHKËT I
MIQËSISË DHE I SUKSESIT.
JEMI VËRTET NJË FAMILJE
E MADHE” – FILLON
PËRSHËNDETJEN E TIJ
ANDREJ KEPE –DREJTORI
RAJONAL I SLLOVENISË
NË DITËN E SUKSESIT NË
LUBLJANË.**



Pas kësaj pjesmarrësit i përshëndeti **Dr Sándor Milesz** -Drejtor i Përgjithshëm i FLP për rajonin , duke i vënë theksin rezultateve të anëtarëve të Klubit të Presidentit. Ata edhe gjatë 2010, bënë gjithshka në interes të asaj që edhe në këtë periudhë të recesionit ekonomik të ruajnë një moral të lartë pune. Qënia anëtar i Klubit të Presidentit nuk është vetëm një nderim; anëtarët e tij konsiderohen edhe një shëmbull model i bashkëpunëtorëve. Ata ngrënë kulturën e bashkëpunimit dhe të respektit, organizojnë seminare, përgatitin materiale dhe mund të na promovojnë. Dr Milesz lavdëroi në mënyrë të veçantë grupin e vogël por profesional dhe të frymëzuar që punojnë në Zyrën e Sllovenisë.

„Kënga është fjala e engjëjve”, tha drejtuesi i programit Soaring Menaxheri **Tomislav Brumec**, pastaj mikrofonin ia dha këngëtares **Tanja Žagar** që me zërin e saj të ngroh shpirtin. Në kuptimin e të qenit i relaksuar, edhe informacionet e reja kapen më lehtë. Këtë shfrytëzoi **Dr Miran Arbeiter**, që gjithmonë në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme prezanton produktet e reja.. As sot nuk ishte ndryshe. **László Molnár**-Drejtor Rajonal i FLP Zagreb na tregoi se si duhet të komunikojmë me mençuri me bashkpunëtorët e mundshëm. „Përgjigjen e përmban pyetja” - thotë ai dhe këtë ide ai e lidh me praktikën.Konkluzionin e duhur mund ta nxjerrë kushdo.

Nga sfondi shijova frymëzimin, kur në skenë pranë **Tanja Žagar** u paraqit **Rok Ferengja**. Kënga e duetit na ndihmoi, që ta dëgjojmë përsëri me vëmendje bisedën e Diamant-Zafir Menaxheres **Aranka Vágási**.





Aranka na tregoi për rrugën që të çon nga niveli i Supervizorit në atë të menaxherit. Na bëri të njohur pervojën e saj, si dhe bashkpunëtorët e vet që nën drejtimin e saj u bënë të sukseshëm. Plot krenari na tregoi se ndërmjet tyre qëndron dhe i biri, që bashkë me ta feston jo vetëm ditëlindjen e Foreverit por edhe ditëlindjen e vet.



U gëzua bashkë me ata që u kualifikuan në nivele më të larta dhe prandaj morëm pjesë edhe në vlerësimin që ju bë atyre. Mund të pyes dikush por pse duhet të gëzohen në një rast të tillë të gjithë, thjeshtë le të gëzohet ai që kualifikohet, por ne e dimë se tek ne funksionon ndryshe: gëzohet edhe sponsori, sepse është sukses i bashkpunëtorit të tij, dhe gëzohen të gjithë sepse mund ta shikojnë me sytë e tyre, që sukcesi nuk është diçka si mirazh, por diçka që është vetëm një hap nga ne dhe që mund të arrihet edhe nga gjithkush.



Tanja gjithnjë na mbulon me hare, ndërsa tash ne vrasim mendjen të befauar. Mendonte se do ta këndonte vetëm këngën e shkruar për duet, kur papritur nga mbas skenës u ndez zëri mahnitës, i legjendës së gjallë **Kemal Monteno**. Shumë mallkojnë fatin duke thënë që ai mund ti ketë bërë të mbeten shtrirë në dysheme. Mendojnë se janë të paaftë për të arritur në bregun tjetër, sepse gjithmonë diçka i kthen mbrapsht. Por e verteta është se nuk duan të eliminojnë pengesat që u dalin në rrugën e tyre.

Pse ja vlen të punosh për të „dalë në anën tjetër”? Për këtë na folën më të mirët:

Tomislav Brumec, Jožica Arbeiter, Maja Stilin, Jadranka K. Pavletič, Safet Mustafić, Vasilije Njegovanović, Stevo Lomjanski, Dragana Janović, Dr. Kósa L. Adolf dhe Róbert Varga. Të gjitha bisedat dhe secili lektor ishte një perlë e vertetë, por prej tyre po





përmendim dy: Dr. **Adolf L. Kósa** na solli në kujtesë kohën e 9 vjetëve më parë kur ai akoma nuk i përkiste familjes tonë të madhe, kur duke qënë një korespondent i dëgjuar i radios, dëgjoji me frymëzim bisedën e **Tomislav Brumecit**. Tomislavi sot është drejtues i programit por dhe shëmbull i gjallë i asaj se në FLP asgjë nuk është e pamundur. Akoma edhe më shumë e bënë për vete audiencën fjalët e lektorit të fundit **Róbert Varga**. Herë herë ishim të sigurtë se ai nuk do të vinte mbasi bashkëshortja e tij pret me ditë lindjen e fëmijës, pra kushtet për udhëtim vërtet nuk i kishte të favorshme. Por Róbi duke sakrifikuar, mbritti në çastin e fundit, mbajti fjalën e tij prej 6 minutash, hypi përsëri në makinë dhe nxitoi përsëri drejt Hungarisë. Përkushtimi dhe vendosmëria e tij për të gjithë ne, është një model që duhet ndjekur: Ju faleminderit për shëmbullin që na dhatë.

Pse e lamë bisedën e **Veronika Lomjanskit** për në fund të ditës? Veronika është Diamantja e parë e rajonit tonë, dhe ndoshta do të ishte me vend që bisedën e saj ta dëgjonim të parën. Por kur njerzit dëgjojnë atë, të gjithëve u krijohet ndjenja që duhet të ndjekin menjëherë shëmbullin e saj. Prandaj pikërisht për këtë serinë e mbyllëm me Veronikën. Duke përfunduar, edhe nga ky takim largohemi me bindjen se gjithkush, vërtet gjithkush, është në gjendje të arrijë atë që **Veronika** dhe **Stevan Lomjanski** tashmë e kanë arritur.

Në fund drejtorët rajonalë ndihmuan shqiponjat e reja të fluturojnë nga foletë duke u dhënë distiktivet gjithë atyre që tashmë e kanë treguar dëshirën e tyre për fluturim, duke u kualifikuar në shkallën e parë të marketingut si asistent supervizora.

Le të takohemi përsëri më 19 Dhjetor 2011 , në takimin e përvjetorit të dhjetë të lindjes!





NIVELIN E MANAGER-IT E ARRITËN

Anikó Kardos
(*Edit Móricz*)

„Ndërto vlerat dhe do të kesh ndërtuar jetën tënde”



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Balen Sanja & Balen Davor
Dr. Szénai László & dr. Szénainé
Kovács Gabriella

Bodnár Ibolya
Borovác Tibor
Csuka-Jevcsák Veronika
Czakó Éva
Donkó Zoltánné
& Donkó Zoltán
Dr. Elek Attila
Dr. Rácsai Lajos Imre
Egeresi János Istvánné
Fedorova Gabriela
Forgó Esztella
Geng Szilvia
Geng Éva
Gvačić Lorena
Hadady Zsófia
Jónás Regina

Kapocsiné Mucsi Beáta
Kordaova Kinga Mgr.
Kosmač Matjaž
& Bajt Nika
Kun Richárd
Megyeriné Péntes Mária
Molnár Gabriella
Orbán Szóka Borbála
& Orbán László
Rimóczi Károly
Šćepanović Mirka
Tóth Ágnes
Válóczy Judit
Vasić Miodrag
& Vasić Slavica
Völgyes Tamás



NIVELIN E SUPERVISOR-IT E ARRITËN

Baranyi Anikó
Berecz Botondné & Berecz Botond



SË BASHKU NË RRUGËN DREJT SUKSESIT

K O S O V A , S E R B I A , M A L I I Z I , S L L O V E N I A

